USHTRIA

Viti i 70-të i botimit Nr. 51 (82696) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 9 dhjetor 2016

NISET KONTIGJENTI I PESTË PËR NË AFGANISTAN



Ditën e hënë, më 5 dhjetor 2016, Shqipëria ka nisur kontingjentin e radhës që do të shërbejë në Resolute Support Mission (RSM), në Afganistan. Ceremonia për përcjelljen e kontingjentit u zhvillua në mjediset e Policisë Ushtarake (PU). Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Dedë Prenga, ambasadori i Republikës së Turqisë në vendin tonë z. Hidayet Bayraktar, komandanti i PU kolonel Arben Kingji, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të MM dhe SHPFA si dhe familjarë të efektivëve që do të nisen në mision.
Ministrja Kodheli në fjalën e saj tha se ky

» faqe 2

Rama në Ministrinë e Mbrojtjes

Rritja e rrogave për ushtarakët 8-10 përqind

Kryeministri Edi Rama garantoi ushtarakët se rritja e pagave do të jetë mbi parashikimin e projekt - buxhetit të shtetit

» faqe 3







Buxheti 2017: Modernizimi i Forcave të Armatosura



» faqe 4

Fjala e ministres Kodheli

20% e FA-së angazhohet jashtë vendit

Kur pak më shumë se tre vjet më parë, si pjesë e kësaj qeverie, mora detyrën e ministrit të Mbrojtjes, problemet e vetme ishin të lidhura pashmangshmërisht me financat. Në fakt, nuk është se u çudita; mënyra sesi menaxhoheshin Forcat e Armatosura, për ne, që vinim nga opozita, ishte e qartë. Reparte ushtarake që përdoreshin për kërkime thesaresh, helikopterë ushtarakë

» faqe 3



Ceremonia

160 ton napalm drejt Francës nisen për shkatërrim

Në Portin e Durrësit u zhvillua diten e martë më 6 dhjetor një ceremoni për të shënuar fundin e një projekti të përbashkët mes Prezencës së OSBE në Shqipëri dhe Ministrisë së Mbrojtjes për shkatërrimin e kimikateve të rrezikshme ushtarake. Të pranishëm ishin kryetari i Prezencës ambasadori Bernd

» faqe 5



NATO

Thellohet bashkëpunimi NATO-BE

» faqe 8-9

ZV/SHEFI I SHPFA - MESAZHI

1912-2016, 104 vjetori i Ushtrisë Shqiptare

faqe 6

HISTORI

Kongresi i Manastirit, jo vetëm i Alfabetit...

faqe 10

Niset kontigjenti i pestë për në Afganistan

Ditën e hënë, më 5 dhjetor 2016, Shqipëria ka nisur kontingjentin e radhës që do të shërbejë në Resolute Support Mission (RSM), në Afganistan. Ceremonia për përcjelljen e kontingjentit u zhvillua në mjediset e Policisë Ushtarake (PU). Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Dedë Prenga, ambasadori i Republikës së Turqisë në vendin tonë z. Hidayet Bayraktar, komandanti i PU kolonel Arben Kingji, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të MM dhe SHPFA si dhe familjarë të efektivëve që do të nisen në mision.

Ministrja Kodheli në fjalën e saj tha se ky 5 dhjetor duhet mbajtur mend gjatë, pasi "është fillimi i një angazhimi të ri, një dimension i rrahur nga shumë kolegë tuaj, por i panjohur për ju". "Për një kohë të gjatë kam diskutuar me drejtuesit e Shtabit të Përgjithshëm, por dhe me komandantin e Policisë Ushtarake, për të bërë të mundur përfaqësimin e batalionit tuaj në një mision jashtë vendit. Dhe ja ky moment u bë realitet! Momente të tilla mbajnë mbi vete edhe shumë tension, mbi të panjohurën që ju pret dhe rreziqet që çdo mision i tillë ka" - vijoi ajo. Ministrja Kodheli theksoi se "sfidat e reja të sigurisë, kërkojnë



me ngulm parjen e bashkëpunimit mes vendeve aleate si mundësinë primare jetike të suksesit, në këto kohë mungesash dhe radikalizmi. Gjendemi së bashku me aleatët tanë në zonat më të nxehta të globit, marrim përsipër angazhime në përmbushje të kërkesave të Aleancës, por dhe mendojmë në çdo moment për përmirësimin e realitetit me të cilin përballemi. Ngjarjet që po ndodhin kudo nëpër botë demonstrojnë rëndësinë që ka mirëpërgatitja për parandalimin e çdo agresioni të mundshëm ndaj Aleancës, apo për t'iu përgjigjur çdo krize të mundshme".

Në fund të fjalës së saj, zonja Kodheli falënderoi aleatët turq për të gjithë ndihmën e dhënë në plotësimin e angazhimit në Afganistan. "Bashkëpunimi me FA turke, mbetet për ne mjaft i rëndësishëm dhe thelbësor".

Në fjalën e tij përshëndetëse ambasadori i Turqisë në vendin tonë, shkëlqesia e tij z. Hidayet Bayraktar, i dha një rëndësi të veçantë marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Ai u shpreh: "Turqia ka mbështetur integrimin e Shqipërisë në institucionet euroatlantike, ndërkohë ajo ka mbështetur edhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Turqia, ashtu si në çdo fushë edhe në fushën ushtarake, ka marrëdhënie të shkëlqyera me Shqipërinë." Më pas, ministrja Kodheli i dorëzoi flamurin kombëtar, komandantit të Kontingjentit të 5-të që niset në Afganistan.Kontingjenti i PU që niset në Afganistan, shënon Kontingjentin e 5-të të efektivave shqiptarë në kuadër të RSM. Ata pritet të zëvendësojnë trupa të kontingjentit të 4-të të Batalionit Komando, të cilët janë aktualisht duke kryer misionin e tyre në varësi të komandës turke në Kabul, Afganistan. Ashtu sikurse edhe kontingjentet e tjera, toga e efektivëve të PU, do të shërbejë për një periudhë 6 - mujore.

Ky 5 dhjetor duhet mbajtur mend gjatë

MIMI KODHELI
Ministre e Mbrojtjes

Sot është një moment i veçantë për Forcat tona të Armatosura. Një togë e Policisë Ushtarake po niset për misionin e saj të parë jashtë vendit, drejt Afganistanit, atje ku ne jemi të pranishëm që nga viti 2002. Për të gjithë ju, djem dhe vajza në uniformë të batalionit të Policisë Ushtarake ky 5 dhjetor duhet mbajtur mend gjatë. Është fillimi i një angazhimi të ri, një dimension i rrahur nga shumë kolegë tuaj, por i panjohur për ju.

Jeni stërvitur e pajisur për të kryer detyra më specifike se shumë nga repartet e Forcave tona të Armatosura. Ju konsiderojmë si një nga repartet më të mirë e më profesionalë që kemi dhe prandaj jeni përzgjedhur për të na përfaqësuar në Kabulin e largët, përkrah aleatëve tanë turq, në ruajtje të aeroportit të atjeshëm.

Për një kohë të gjatë kam diskutuar me drejtuesit e Shtabit të Përgjithshëm, por dhe me komandantin e Policisë Ushtarake, për të bërë të mundur përfaqësimin e batalionit tuaj në një mision jashtë vendit. Dhe ja ky moment u bë realitet! Momente të tilla mbajnë mbi vete edhe shumë tension, mbi të panjohurën që ju pret dhe rreziqet që çdo mision i tillë ka. Por fakti që drejtoheni nga komandant Kingji, mua personalisht më jep shumë besim. Ai ka qenë komandanti i misionit të parë shqiptar në Kabul në vitin 2002. E njeh mirë realitetin që ju pret dhe jam e bindur se ju ka instruktuar më mirë se kushdo tjetër në



këtë angazhim të rëndësishëm tonin.

Sfidat e reja të sigurisë, kërkojnë me ngulm parjen e bashkëpunimit mes vendeve aleate si mundësinë primare jetike të suksesit në këto kohë mungesash dhe radikalizmi. Gjendemi së bashku me aleatët tanë në zonat më të nxehta të globit, marrim përsipër angazhime në përmbushje të kërkesave të Aleancës, por dhe mendojmë në çdo moment për përmirësimin e realitetit me të cilin përballemi. Ngjarjet që po ndodhin kudo nëpër botë demonstrojnë rëndësinë që ka mirëpërgatitja për parandalimin e çdo agresioni të mundshëm ndaj Aleancës apo për t'iu përgjigjur çdo krize të mundshme.

Jemi të pranishëm në Afganistan prej plot 14 vjetësh, fillimisht në formatin ISAF e, që prej dy vitesh, si pjesë e misionit Resolute Support, duke iu bashkuar që në fillim koalicionit ndërkombëtar në luftë kundër terrorizmit. Jemi të pranishëm atje, fillimisht si vend partner e më pas si anëtar më të drejta të plota të Aleancës, për t'u dhënë afganëve liri nga shtypja dhe terrori si dhe për t'i ndihmuar ata në krijimin e sigurisë dhe stabilitetit për vendin e tyre. Sot, forcat ushtarake të NATO-s nuk patrullojnë më fshatrat e qytetet afgane, por janë të angazhuara në trajnimin dhe stërvitjen e afganëve, të cilët po rimarrin në duar fatet e vendit të tyre. Dua të falënderoj aleatët tanë turq për të gjithë ndihmën e dhënë në plotësimin e angazhimit tonë në Afganistan. Bashkëpunimi me Forcat e Armatosura turke, mbetet për ne mjaft i rëndësishëm dhe thelbësor. Ne do të jemi në Afganistan, do të dyfishojmë angazhimin tonë duke nisur nga e shtuna e ardhshme si dhe do të ndjekim me vëmendje kërkesat dhe nevojat e Aleancës për ekspertizën tonë. Në unison të plotë me aleatët amerikanë, turq, italianë, gjermanë si dhe në kuadër të Kartës së Adriatikut, ne do të plotësojmë detyrimet e marra vite më parë. Dhe jemi krenarë për këtë!



Hidayet Bayraktar
Ambasador
i Republikës së
Turqisë në Shqipëri

Marrëdhënie të shkëlqyera në fushën ushtarake

Jemi mbledhur këtu sot për të përcjellë kontingjentin e përbërë nga 30 persona të efektivit të Ushtrisë Shqiptare të cilët nën komandën turke do të zhvillojnë misionin e tyre në kuadrin e NATO. Jam tepër i lumtur dhe tepër i kënaqur që marr pjesë në këtë ceremoni përcjelljeje. Turqia ka mbështetur integrimin e Shqipërisë në institucionet euroatlantike, po ashtu ajo ka mbështetur edhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Turqia, ashtu si në çdo fushë edhe në fushën ushtarake, ka marrëdhënie të shkëlqyera me Shqipërinë. Sot kërcënimet rajonale dhe globale po arrijnë përmasa tepër të vështira.

Në këtë situatë rritet akoma më shumë roli rajonal dhe global i NATO për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në botë. Turqia është një mbështetëse e politikës e dyerve të hapura të NATO, në të njëjtën kohë e shikon këtë aleancë si një garanci të fuqishme për stabilitetin dhe paqen në Ballkan. Në këtë kuadër Turqia e shikon si tepër kuptimplotë dhe tepër të rëndësishëm kontributin që jep Shqipëria, aleatja jonë në NATO, kontribut, të cilën e jep edhe në Afganistan në kuadrin e komandës së NATO.

Në këtë kuadër ne e shikojmë si një hap konkret, i cili realizon më së miri besnikërinë e Shqipërisë ndaj NATO e në të njëjtën kohë edhe realizimin e objektivave të përbashkëta në kuadrin e NATO. Këto veprimtari të palës shqiptare kanë filluar në 16 dhjetor të vitit 2014 dhe sot është Kontingjenti i 5-të që po vazhdon këtë rrugë. Në të njëjtën kohë ne mendojmë se këto veprimtari të palës shqiptare do të ndikojnë në rritjen e prestigjit dhe të autoritetit të saj në planin ndërkombëtar. Gjithashtu kemi bindjen se do të çojë në një nivel më të lartë marrëdhëniet ushtarake midis Shqipërisë dhe Turqisë.

Ne jemi mbledhur sot për të përcjellë këtë mision tepër të rëndësishëm. Unë ju uroj suksese në detyrën e tyre tepër të rëndësishme të gjithë personelit ushtarak shqiptar, të cilin po e përcjellim sot. Uroj që ata të kthehen shëndoshë e mirë. Në të njëjtën kohë i garantoj të gjithë pjesëtarët e familjeve të tyre që këta do të kthehen më një eksperiencë të çmuar.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Albert **ZHOLI**

Gazetarë:
Saimir **ALIJA**
Ilir **LAME**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**
Redaktore/Korrektore:
Anila **DODA**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Rama në Ministrinë e Mbrojtjes

Rritja e rrogave për ushtarakët 8-10 përqind

Kryeministri Edi Rama garantoi ushtarakët se rritja e pagave do të jetë mbi parashikimin e projekt - buxhetit të shtetit



Në një takim të zhvilluar me ushtarakët në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, ditën e martë, më 6 korrik 2016, ku merrnin pjesë ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dhe ministri i Financave z. Arben Ahmetaj, kreu i qeverisë Edi Rama, tha se se paga e ushtarakëve do të rritet nga 5÷7 % që ishte parashikimi, në 8÷10%. "Jemi midis një rritjeje 5÷7 % të rrogës për ushtarakët, që në këndvështrimin tim nuk është mjaft dhe një rritjeje 8÷10%, që është paralele si rritja për të gjithë të tjerët. Kjo është beteja dhe unë kam shumë shpresë qëbrendakësaj periudhe që po kalojmë, nga diskutimi i buxhetit në parim, në diskutimin e buxhetit zë për zë, ne do arrijmë që ta akomodojmë dhe këtë pjesë për ushtarakët në këto nivele. Pra, të mos kemi një rritje më të ulët se sa ajo e punonjësve të policisë, apo se sa ajo e mësuesve dhe e mjekëve. Kjo është pak a shumë ambicia jonë, ndërkohë që edhe këtu, si në të gjithë sektorët e tjerë, për ata që kanë pagën më të ulët, flas për gjithë shërbimet mbështetëse, për ata që mbajnë pastër këtë kompleks të mrekullueshëm dhe që krijojnë kushte që ju të gjithë të punoni në këtë higjenë kaq të garantuar, rroga do të rritet 36%", - deklaroi z. Rama.

Ndërkohë kryeministri nuk ka munguar së bëri edhe humor, teksa nënvizoi se "nuk do të arrini dot të më shani përpara njerëzve të shtëpisë, sepse kam bindjen që edhe pas këtij takimi i kam të gjitha argumentat për ta fituar betejën për atë diferencën që kam me ministrin e Financave dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar!", - deklaroi kryeministri.

Z. Rama tha se kësaj kategorie iu rikthye dinjiteti i nëpërkëmbur në këto vite, ndësa theksoi se pavarësisht kësaj, ka ende shumë për të bërë ndaj ushtarakëve, pavarësisht borxhit në akumuluar dhe tashmë të paguar në Ministrinë e Mbrojtjes, një borxh prej 16 milion Euro.

Ndërsa ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli duke i uruar edhe njëherë ushtarakët për 104 - vjetorin e krijimit të FA, nënvizoi punën e bërë për rikthimin e dinjitetit të ushtarakëve, duke e vënë theksin tek përmirësimi i financave të rrënuara nga qeverisja e kaluar në këtë ministri. "Mënyra se si menaxhoheshin Forcat e Armatosura, për ne që vinim nga opozita, ishte e qartë. Reparte ushtarake që përdoreshin për kërkime thesarësh, helikopterë ushtarakë që fluturonin për video muzikore, aparate përgjimi që kushtonin miliona euro e përgjonin politikanë të opozitës e diplomatë të huaj, koncerte që kushtonin më shumë se çdo paketë modernizimi luftarak, pa harruar mungesën e karburantit për anijet e Forcës Detare, në ruajtje të bregdetit", - tha znj. Kodheli.

Ministrja e Mbrojtjes nënvizoi faktin se u përballua borxhi i akumuluar prej 16 milion eurosh, ndërkohë që tashmë ushtria shqiptare është pjesë e misioneve më të rëndësishme të Aleancës në pikat më të nxehta të globit. Nga ana tjetër, znj. Kodheli evidentoi dhe punën e bërë për modernizimin e ushtrisë përmes marrëveshjeve me partnerët tanë në NATO dhe aleatin më të rëndësishëm SHBA.

Ministrja e Mbrojtjes tha se është vendosur standardi i sigurimit të jetës së të gjithë ushtarakëve që janë pjesë e ekuipazheve fluturuese, ashtu siç janë mbuluar me siguracion të gjithë helikopterët, por gjithashtu dhe anijet që janë në mision jashtë vendit. Znj. Kodheli në përfundim të fjalës së saj garantoi dhe njëherë se premtimi i qeverisë për rritjen e rrogave të ushtarakëve jo vetëm është realizuar por dhe tejkaluar.

> *"Kësaj kategorie iu rikthye dinjiteti i nëpërkëmbur në këto vite, ndësa theksoi se pavarësisht kësaj, ka ende shumë për të bërë ndaj ushtarakëve, pavarësisht borxhit në akumuluar dhe tashmë të paguar në Ministrinë e Mbrojtjes, një borxh prej 16 milion Euro".*

20% e FA-së angazhohet jashtë vendit

Fjala e plotë e ministres së Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli në takimin me ushtarakët

Kur pak më shumë se tre vjet më parë, si pjesë e kësaj qeverie, mora detyrën e ministrit të Mbrojtjes, problemet e vetme ishin të lidhura pashmangshmërisht me financat. Në fakt, nuk është se u çudita; mënyra sesi menaxhoheshin Forcat e Armatosura, për ne, që vinim nga opozita, ishte e qartë. Reparte ushtarake që përdoreshin për kërkime thesaresh, helikopterë ushtarakë që fluturonin për video muzikore, aparate përgjimi që kushtonin miliona euro e përgjonin politikanë të opozitës e diplomatë të huaj, koncerte që kushtonin më shumë se çdo paketë modernizimi luftarak, pa harruar mungesën e karburantit për anijet e Forcës Detare, në ruajtje të bregdetit, por nuk e kishim pritur që borxhi i akumuluar në Ministrinë e Mbrojtjes të ishte në nivelin e 16 milionë Eurove. Shpenzohej për çdo gjë, por nuk punohej mbi asnjë projekt të qartë modernizimi. Edhe paketa e helikopterëve të blerë nuk pati në thelb dëshirën për të rinovuar flotën e mjeteve fluturuese, por u përdor politikisht për fushatat elektorale.



E njëjta situatë e zymtë mbizotëronte përsa i përket mundësive financiare të njerëzve në uniformë. Çdo gjë i duhej paguar sistemit të korruptuar të ngritur nga bashkëpunimi i politikanëve me disa ushtarakë të padenjë për uniformën që mbanin. Dhe ato vlerat që ne përmendim shpesh si ndershmëria e patriotizmi, tek elita drejtuese ishin shndërruar në ryshfet për vende pune, marrjen e gradës së radhës, si dhe për të shkuar në mision jashtë vendit.

Paguhej për çdo gjë, si në një shoqëri orientale të Mesjetës, ku bakshishi e ryshfeti lubrifikonin administratën në krye të një Force të Armatosur të një vendi anëtar të NATO. Ironia më e madhe ishte heqja e trajtimit ushqimor për ushtarakët në gusht të 2013, nga një qeveri e cila e kishte humbur mandatin popullor për të marrë të tilla vendime.

E nisëm pikërisht këtu, me pastrimin e skorieve korruptive mbi çelikun e fortë të ushtarakëve tanë. Por, nuk ishte e vështirë aspak, pasi çibani i korrupsionit nuk qëndron dot mbi idealet e ushtarakut. U këputën një nga një pjesët e zinxhirit korruptiv, pa dallim grade e pozicioni. Buxheti i vitit 2014 kishte si synim stabilizimin e situatës financiare të gjetur, pagimin e borxheve të akumuluara në 16 milion euro, si dhe nisjen e procesit real të modernizimit të Forcave tona të Armatosura. E nisëm vitin e parë të punës me buxhetin e hartuar prej nesh, duke ju kthyer të gjithë juve, të nderuar ushtarakë, trajtimin ushqimor të përmuajshëm. Rikthimi i trajtimit ushqimor për mbi 6500 ushtarakë erdhi me një formulë më sociale, duke u dhënë më shumë ushtarëve, si shtresa me pagën më të ulët në zinxhirin e gradave.

Gjithashtu, për herë të parë, u hartuan plane të qarta të modernizimit të armatimit, pajisjeve dhe teknikës ushtarake. Që në 300 ditët e para të qeverisjes sonë, u përmbyll faza e parë e heqjes së kallashnikovit nga përdorimi. Të parat që u pajisën me armatim dhe municion të standardeve të NATO, ishin trupat që merrnin pjesë në misionet paqeruajtëse, ku ne ishim të angazhuar. Ndërhymë në pagat e pilotëve, si kategoria më e rrezikuar dhe me vështirësinë më të madhe gjatë kryerjes së detyrës. I gjetëm pilotët që paguheshin thjesht për gradën që merrnin. Pilotët tashmë kanë pothuajse një vit e gjysmë, që marrin 40.000 Lek shtesë në muaj.

Në mënyrë të shkallëzuar, përfitojnë gjithashtu të gjithë ushtarakët që punojnë në Forcat Ajrore dhe janë pjesë e ekuipazheve fluturuese.

Kemi vendosur standardin e sigurimit të jetës së të gjithë ushtarakëve që janë pjesë e ekuipazheve fluturuese, ashtu siç kemi mbuluar me siguracion të gjithë helikopterët, por gjithashtu dhe anijet që janë në mision jashtë vendit.

Pak kohë më parë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale, u mbyll problematika e madhe e borxhit që ish-ushtarakët i kishin qeverisë. Borxhi i tyre u fal. Rreth 10 milion dollarë që do të paguheshin si debi nga rreth 5400 ish-ushtarakë do të qëndrojnë në xhepat e tyre.

5% e njerëzve në uniformë marrin pjesë në misione ushtarake jashtë vendit, nga Afganistani në Kosovë, nga Letonia në Mali, nga Bosnja në detin Egje. Mbi 300 burra e gra punojnë çdo ditë në shtabet dhe komandat e Aleancës, duke kryer detyra nga më të ndryshmet.

15% e ushtarakëve marrin pjesë çdo vit, në stërvitje jashtë vendit. Janë mbi 1000 njerëz në uniformë që përgatiten me aleatët e tyre për sfidat e reja të sigurisë. Nëse 20% e Forcave të Armatosura gjendet e angazhuar jashtë vendit çdo vit, ne përgatitemi për pjesën tjetër, e cila plotëson ciklet rotacionale në vitet në vazhdim. Gjithçka bëhet më paratë që kemi në dispozicion, por gjithashtu shfrytëzojmë në maksimum edhe bashkëpunimin e ngushtë me aleatët tanë të NATO.

Në vitin 2017, Ministria e Mbrojtjes italiane do të na dhurojë 5000 pushkë automatike të standardeve të NATO duke plotësuar kështu njëherë e mirë nevojën për armatim perëndimor. Jemi vendi i parë lindor që do të heqë dorë përfundimisht nga kallashnikovi i Luftës së Ftohtë.Edhe një sasi e konsiderueshme mjetesh të blinduara do të vijnë që në fillim të vitit që po vjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të plotësuar nevojën për transport luftarak për trupat që ne kemi në misione jashtë vendit.

Buxheti 2017: Modernizimi i Forcave të Armatosura

Kodheli: "Ky buxhet përmbush me sukses misionin tonë kushtetues në shërbim të mbrojtjes dhe sigurisë së Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha angazhimeve tona në raport me Aleancën"



Kuvendi i Shqipërisë miratoi në parim, në orët e para të së premtes (ora 02:40 pasmesnata), datë 2 dhjetor 2016, projektbuxhetin e shtetit për vitin 2017. Me 82 vota pro dhe dy vota kundër deputetët e maxhorancës kaluan pas 16 orë debatesh ligjin më të rëndësishëm të qeverisë, të cilin e konsideruan mbështetës të reformave të mëdha të vendit për vitin në vazhdim. Opozita nuk mori pjesë në votim pasi e konsideroi buxhetin e ri varfërues për shqiptarët. Krahas pr/buxhetit deputetët miratuan dhe ligjet e paketës fiskale. Me 80 vota pro dhe dy vota kundër u miratuan ndryshimet në ligjin "Për akcizat", ndërsa me 82 vota prio dhe dy kundër kaluan dhe ndryshimet në ligjin "Për taksat kombëtare", ato në ligjin "Për nivelet e tarifës doganore" dhe ato në në ligjin "Mbi tatimin për të ardhurat".

Në këtë seancë Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli ka prezantuar para deputetëve projekt - buxhetin e Mbrojtjes për vitin 2017, për të cilin u shpreh se përmbush të gjitha nevojat dhe detyrimet për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, që nga pjesëmarrja në misionet jashtë vendit, te stërvitjet brenda dhe jashtë vendit, te angazhimi në emergjencat civile, te pastrimi i hot-spoteve, te përmirësimi i mëtejshëm i kushteve të ushtarakëve dhe rritja e dinjitetit të figurës së tyre.Siç edhe nënvizoi ministrja Kodheli, një pjesë e mirë e këtij projekt - buxheti shkon për modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare.

Po botojmë të plotë, fjalën e ministres së Mbrojtjes znj.Mimi Kodheli në Kuvendin e Shqipërisë, për prezantimin e projekt – buxhetit të Mbrojtjes për vitin 2017.

"Diskutimin tim të sotëm mbi projekt - buxhetin e vitit 2017 do doja ta bëja nisur nga një këndvështrim i ndryshëm prej diskursit klasik parlamentar, ku pala qeverisëse lëvdon dhe pala opozitare kundërshton, me apo pa argumente politike apo shifrore.Në qeverisjen e mëparshme, sa më hiperbolike të ishte premtimi apo shifra si (p.sh. të dytët pas Gjermanisë), aq më mbresëlënës tek qytetarët mendohej të ishte diskutimi në foltoren e Parlamentit. Dhe t'ju them të drejtën shpesh herë keni ditur ta bëni mirë këtë gjë, pasi keni zbatuar parimin "sa më e madhe e pavërteta, aq më e besueshme". Por ajo çka harrohej qëllimisht në diskutimet e radhës për buxhetin, llogaridhënie të cilës i jeni larguar si "djalli temjanit" ishte se, ku, si dhe për çfarë, ishin harxhuar këto para, pavarësisht përqindjeve në raport me PBB. Sot rrihni me grusht tavolinat, gjuani me letra publike se ju dhemb për Buxhetin e Mbrojtjes. Shumë mirë bëni! Por a e dini ju zotërinj si janë menaxhuar financat e Ministrisë së Mbrojtjes dikur?

A jo! Ju, kur ishit në pushtet, nuk keni lejuar as anëtarët opozitarë të Komisionit të Sigurisë të futeshin as deri tek oborri i Ministrisë së Mbrojtjes për të marrë ndonjë informacion më shumë se ç'bëhej me aktivitetin e ministrisë, megjithëse ata ishin në të drejtën e tyre kushtetuese. Mbase asokohe nuk e shihnit të arsyeshme fare të diskutonit me ligjvënësit, pasi jam e sigurt që e kishit konsultuar me Institucionin e Presidentit, buxhetin më parë. Pyes në mënyrë retorike sot, qytetarët e vendit tim, nëse e dinë se për çfarë kanë shkuar shumë nga paratë e taksave të tyre në atë kohë, ku rrihej gjoksi se "mbi 1% e PBB shkonte për Mbrojtjen?" Po ju jap pak shembuj të përzgjedhur rëndom, pasi dua vetëm të krijohet ideja e të rikthehet në memorien e shumëkujt që e ka harruar, por në fakt dua t'i mbetem pak më pas diskutimit vetëm të buxhetit 2017. Do të jenë vetëm pak shembuj sepse nuk është e nevojshme që të pish të gjithë ujin e detit për ta kuptuar që është i kripur: 1,2 milion euro për një koncert të vetëm; 1,6 milion euro për një aparat përgjimi (për të cilën ushtria s'kishte nevojë dhe as detyrim dhe ishte në shkelje të Kushtetutës); 2,5 milion euro për rikonstruksionin e një sheshi brenda garnizonit, kur ndërtesat aq më pak repartet ushtarake nuk kishin as bojë e jo me rikonstruksion, që para viteve '90; 1,5 milion euro për të bërë plot tre herë rikonstruksionin e një ndërtese, gjithmonë brenda garnizonit kjo, që nuk shfrytëzohet as sot, sepse dhe sot MM është hedhur në gjyq me të drejtë nga firma ndërtuese e fundit në radhë dhe lekët kanë shkuar në drejtim të paditur.

Dhe në fund shumë e shumë miliona të harxhuara pa plan, pa kërkesë operacionale. Dhe, megjithëse janë harxhuar kaq para, MM trashëgoi plot 16 milionë euro borxhe, fatura të papaguara që nga 2008; zero litra naftë për anijet e Rojes Bregdetare tre muaj para se të mbyllej viti 2013, që do të thotë gatishmëria zero në ruajtje të kufijve tanë detarë të Republikës së Shqipërisë, apo qindra ushtarakë dhe civilë të futur në punë në muajt e fundit të vitit elektoral me sigurime shoqërore të papaguara, e sa e sa kusure të tjera.Por unë them të shikojmë përpara.Dhe ja ku vij tek komenti im mbi atë për çka diskutojmë sot: Projekt-buxhetin e vitit 2017, i cili është:

Buxheti i Rritjes
Ekonomike: 3,8%

Shumë vende të Europës do ta dëshironin dhe ëndërronin shumë. Pozitiv është fakti se burimet kryesore të cilat do të gjenerojnë këtë rritje parashikohet të jenë investimet dhe konsumi privat. Niveli i lartë i investimeve publike i parashikuar për vitin 2017 në masën 5% të PBB, pritet të jetë një faktor i rëndësishëm dhe kryesor i rritjes ekonomike.

Buxheti i reformave

Ky buxhet është buxheti i reformave, janë plot 20 miliardë lekë për akomodimin e këtyre reformave: ajo në drejtësi, në administratën publike, e pensioneve, e decentralizimit dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, ajo e ujit.

Buxheti i Konsolidimit Fiskal

Borxhi do te ulet nga 71,8% në 69,1% të PBB. Nuk ka ndodhur në asnjë vit elektoral që shpenzimet për aktivitet e qeverisë të jenë më të ulëta se sa të ardhurat buxhetore. Kjo do të ndodhë në vitin elektoral 2017.

Ky është Buxheti i Rritjes së Pagave dhe Pensioneve

Për herë të parë programohen rreth 100 milion dollarë rritje pagash e pensionesh në një vit të vetëm, fondi më i madh i akorduar brenda një buxheti në këto 25 vitet e fundit, rritje nga e cila do të përfitojnë 600.000 pensionistë dhe 110.000 punonjës të administratës publike, dhe kjo pa marrë para borxh dhe pa privatizuar ndonjë ndërtesë historike në Tiranë. Dhe meqenëse jemi tek kjo pikë, FA do të mund të përfitojnë plot 230 milion lekë të reja nga kjo rritje, pas më shumë se 12 vitesh stanjacion në pagat e tyre. Ndërkohë kemi falur detyrimin e llogaritur gabim për mbi 5000 ish-ushtarakë, të cilëve në shumën 1 milard lekë do t'i kthehet, ky i presupozuar llogaritje gabim e pensioneve të tyre.

Buxheti i investimeve publike

E përsëris 5% e PBB: Investimet publike do të vazhdojnë të mbështesin sektorët kyç të ekonomisë: arsim, shëndetësi, bujqësi, transport, përkujdesje sociale, rend dhe siguri. Dhe meqenëse jemi tek rendi dhe siguria, disa fjalë për procesin dhe objektivat tona si MM, të mbështetura nga buxheti i akorduar.Me gjithë rezultatet e shkëlqyera në përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimet që FA kanë në mbështetje të popullsisë dhe në përmbushje të detyrimeve në kuadër të Aleancës programi i ri qeverisës në fushën e Mbrojtjes përmban objektiva akoma më ambiciozë. Mjedisi kompleks i sigurisë ka sfiduar dhe paraqitet si një kërcënim për vlerat që vendi ynë përfaqëson dhe vendeve të demokracive perëndimore. Përballja me sulmet terroriste, ekstremizmi, refugjatët, emergjencat civile, kërcënimet hibride dhe konvencionale në Lindje dhe në Jug të Aleancës kërkojnë tejkalim të problematikave dhe përgatitje edhe reformime akoma dhe më të thella të FA, duke ndërmarrë veprime të cilat ky buxhet mund të na i mundësojë plotësisht, madje diku, diku, me tejkalime të angazhimeve tona NATO të përcaktuara më parë.

Pa dashur të bëj leksion mbi përmbajtjen e buxhetit, por diktuar nga nevoja për të shpjeguar disa gjëra, duke ju kërkuar ndjesë për këtë qasje, më lejoni që në mënyrë të thjeshtë, sidomos për publikun, të them se buxheti i një institucioni është shuma e parave që vihen në dispozicion të tij për të kryer funksionet dhe misionin e përcaktuar. Angazhimi i vendit tonë në Aleancë si dhe angazhimi e kontributi ynë në këtë organizëm janë vlerësuar prej Aleancës dhe ky vlerësim është shpërblyer përveç të tjerash dhe në mbështetjen teknike dhe logjistike për FA. Kjo e ka ulur dukshëm nevojën për para, për shkak se një pjesë të nevojave për modernizimin e FA plotësohen pikërisht nga kjo mbështetje e aleatëve tanë, para, të cilat nëse do të duheshin të përdoreshin do të vinin nga taksapaguesit shqiptarë dhe do t'i kushtonin këtyre taksapaguesve plot 3,7 miliard lekë ose 28 milion dollarë. Kjo në fakt do të kënaqte aritmetikën e cilitdo personi të shqetësuar me të drejtë, pasi e ngre nivelin e buxhetit tonë në fakt në raport me GDB në masën 0,99 %, para këto që në kushte të tjera do të paguheshin, e ritheksoj, nga taksapaguesit vendas, nëse do të përballoheshin nga buxheti.

Në këto rrethana qeveria ka preferuar që këto para, pa cenuar misionin kushtetues të FA, t'i përdorë për arsim, shëndetësi. luftën kundër krimit të organizuar, bujqësi, rritjen e rrogave dhe pensioneve dhe fusha të tjera prioritare. Përtej kësaj, me këtë buxhet, ne do të mund të sigurojmë:

- Rritje të mëtejshme të reputacionit të spikatur ndërkombëtar të MM dhe FARSH:
- Nivelin e kërkuar operacional për 23 formacionet luftarake;
- Pjesëmarrje në misionet e NATO, duke rritur nivelin e angazhimit të FA: dyfish të prezencës ushtarake në RSM Afganistan dhe KFOR;
- Prezencë në misionin detar në detin Egje, pa pasur frikë se na mungon karburanti në fund të muajit apo vitit;
- Prezencën në 2 misionet e BE, BH dhe Mali;
- Prezencë në Grup - Batalionin e Ndërhyrjes Shumë të Shpejtë në Letoni;
- Pjesëmarrje në stërvitje të përbashkëta në kuadër të mbrojtjes kolektive
- Operacione në ndihmë të popullsisë në rast emergjencash dhe ato SAR;
- Operacione në pastrim hot-spotesh dhe ato të rritjes së sigurisë së mjediseve ushtarake;
- Përmirësim të mëtejshëm të kushteve të ushtarakëve dhe rritje të dinjitetit të figurës së tyre;
- Pajisje e gjithë FA me armatim të lehtë të standardeve të NATO, angazhim ky për t'u plotësuar në fund të vitin 2019, si edhe plotësim i të gjithë nevojave për mjete transporti të rëndë, angazhim ky për t'u plotësuar brenda vitin 2025.
- Pajisje harduerike dhe softuerike për sistemet e komunikimit në FA dhe implementimi sistemit të administrimit financiar;
- Edhe kontribute në operacionet e drejtuara nga OKB.
- Funksionim të të parës njollë të NATO në territorin e RSH, Qendrës së Ekselencës për adresimin e fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, të gjitha këto para të paguara nga buxheti i akorduar.
- Rritje te orëve të patrullimit në det dhe orëve të fluturimit sipas standardeve të NATO;
- Mbajtje në operacionalitet të plotë të pajisjeve të FA:

Duke përfunduar më lejoni të shpreh edhe një herë bindjen time të palëkundur dhe të siguroj qeverinë, Parlamentin dhe taksapaguesit shqiptarë se ne do t'ia dalim që me këtë buxhet si dhe masat që do të marrim për përdorimin e tij efikas dhe efiçent të plotësojmë me sukses misionin tonë kushtetues në shërbim të mbrojtjes dhe sigurisë së Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha angazhimeve tona në raport me Aleancën".

Ura ”bailey” në fshatin Grazhdan

Efektivët e Batalionit të Xhenios të Forcave të Armatosura përfunduan ndërtimin e urës ”bailey” në fshatin Grazhdan, Njësia Administrative Kukur të Bashkisë Gramsh. Për dorëzimin e kësaj ure tek autoritetet vendore ishin të pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, i shoqëruar nga deputeti i zonës z. Anastas Angjeli, kryetarja e Bashkisë së Gramshit znj. Luljeta Dollani, si dhe banorë të zonës.

Në përshëndetjen e tij drejtuar banorëve, zëvendësministri Koçi, i falënderoi ata për mikpritjen dhe mbështetjen që u kanë dhënë Forcave të Armatosura, gjatë kryerjes së punimeve për ndërtimin e urës, si dhe theksoi se Forcat e Armatosura do të vijojnë të kontribuojnë në mbështetje të komunitetit.

Nga ana e saj kryetarja e Bashkisë së Gramshit znj. Luljeta Dollani, ka falënderuar ministren e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura për kontributin e dhënë dhe punën e bërë për ndërtimin e urës të fshatit Grazhdan.

Një falënderim i veçantë për Forcat e Armatosura erdhi nga mësuesit dhe nxënësit kësaj zone, të cilët për të shkuar në shkollë u duhej të kalonin lumin në këmbë duke rrezikuar jetën e tyre dhe kur kjo gjë ishte e pamundur, ata mungonin. Ura “bailey” në fshatin Grazhdan me gjatësi 45 m dhe me peshëmbajtje deri në 15 ton, i shërben fshatrave të Njësisë Administrative Kukur, si dhe njëkohësisht lidh këtë njësi me Njësinë Administrative Velçan të Bashkisë Pogradec, duke i lehtësuar jetën rreth 4000 banorëve të kësaj zone.



160 ton napalm drejt Francës nisen për shkatërrim

Ky projekt u mbështet nga Austria, Republika Çeke, Gjermania, Norvegjia dhe Turqia



Në Portin e Durrësit u zhvillua diten e martë më 6 dhjetor një ceremoni për të shënuar fundin e një projekti të përbashkët mes Prezencës së OSBE në Shqipëri dhe Ministrisë së Mbrojtjes për shkatërrimin e kimikateve të rrezikshme ushtarake. Të pranishëm ishin kryetari i Prezencës ambasadori Bernd Borchardt, ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli dhe përfaqësues të trupit diplomatik, shtetet e të cilëve kanë financuar këtë projekt.

Ministrja Kodheli u shpreh mjaft e kënaqur që ishte në ceremoninë përmbyllëse, e cila kurorëzoi me sukses përpjekjet e përbashkëta. “Kjo ceremoni pason atë që zhvilluam së bashku, vitin e kaluar, në Qafë Mollë, për të njëjtin qëllim, përfundimin e grumbullimit, vlerësimit dhe ripaketimit të mbetjeve kimike dhe fillimin e fazës tjetër, asaj të transportit për t’u eliminuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Më tej, ajo tha: “si ministër i Mbrojtjes, por edhe si qytetar i këtij vendi, kam kënaqësinë të shoh se si, në një kohë relativisht të shkurtër, procesi i eliminimit të mbetjeve kimike, çliron nga barra Forcat e Armatosura dhe eliminon rreziqet që ato paraqesin.”

Ministrja e Mbrojtjes theksoi se: “Realizimi i këtij projekti, nuk do të kishte qenë i mundur pa përpjekjet, planifikimin dhe bashkëpunimin e ngushtë të Ministrisë së Mbrojtjes me Prezencën e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Europë në vendin tonë, kjo, jo vetëm për sasinë e konsiderueshme, por edhe për natyrën e rrezikshme dhe koston e projektit”.

Në përfundim të fjalës së saj Kodheli shtoi: “Me këtë rast, falënderoj pjesëtarët e Forcave të Armatosura që u angazhuan dhe kontribuan në realizimin e projektit; konkretisht: personelin e Kompanisë së Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë të Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse, të cilët kanë punuar me përkushtim dhe profesionalizëm për përfundimin me cilësi dhe në kohë të tij. Gjithashtu, falënderoj dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm, të cilat kanë planifikuar, koordinuar dhe monitoruar këtë projekt”

Kryetari i Prezencës, ambasadori Bernd Borchardt, në fjalën e tij tha se me mbështetjen e OSBE, Shqipëria ka bërë përparim mbresëlënës drejt demilitarizimit në vitet e fundit. Në vitin 2015 u asgjësuan me sukses 116 ton kimikate të rrezikshme: “Sot, bëjmë përgatitjet e fundit për dërgimin e 167 ton mbetjeve napalm në Francë për asgjësimin përfundimtar. Për këtë arsye, dua të falënderoj veçanërisht shtetet pjesëmarrëse që kanë mbështetur projektet tona në këtë fushë, konkretisht Austrinë, Republikën Çeke, Gjermaninë, Norvegjinë dhe Turqinë.

Më tej, ambasadori Borchardt falënderoi edhe Njësitë Kimike të FA shqiptare, për punën e shkëlqyer gjithë këto vite. “Roli juaj në këtë proces duhet nënvizuar dhe lavdëruar, sepse të gjithë e dimë se sa e rrezikshme ishte ajo punë. Kjo që keni bërë për vendin tuaj është e jashtëzakonshme”.

Ky projekt është në vazhdim të marrëveshjes që ka Ministria e Mbrojtjes me prezencën e OSBE në Tiranë, në kuadër të marrëveshjes së vitit 2014 për eliminimin e kimikateve stoqe në FA. Këto kimikate do të trajtohen në Francë në linja të standardeve europiane. Në bazë të marrëveshjes, totali i eliminuar deri në këto moment është afërsisht 300 ton.

Kthehet nga Afrika grupi i specialisteve EOD

Grupi i dytë i specialistëve EOD i drejtuar nga major Artan Azizi, i cili shërbeu për një periudhë gjashtë mujore në misionin EUTM (Misioni Trajnues i Bashkimit Evropian) në Mali të Afrikë u kthye në Atdhe.

Ky grup u zëvendësua nga grupi i tretë i specialistëve të kompanisë EOD (Explosive Ordnance Disposal), të cilët tashmë kanë startuar misionin EUTM (Misioni Trajnues i Bashkimit Evropian) në Mali të Afrikës dhe përfaqësojnë Shqipërinë si vendin e 25-të Evropian në këtë mision.

Në Aeroportin Nënë Tereza të Rinasit (TIA), efektivi u prit nga Komandanti i Komandës Mbështetëse Kolonel Ardian Bali dhe Komandanti i batalionit të Xhenios Kolonel Ernest Prençe, të cilët, ju uruan mirëseardhjen në Atdhe, duke i falënderuar ata për përfaqësimin dinjitoz të Forcave të Armatosura dhe përmbushjen me sukses të misionit të ngarkuar.



Zëvëndësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcava të Armatosura

1912-2016, 104 vjetori i Ushtrisë Shqiptare

Mesazh urimi me rastin e 104 vjetorit të krijimit të Ushtrisë Shqiptare



Të nderuar ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë që shërbeni në Forcat e Armatosura të RSH,

më lejoni t'ju shpreh urimet më të përzemërta në 104 - vjetorin e krijimit të Ushtrisë Shqiptare.

Në 4 Dhjetor 1912 u formua Ushtria Shqiptare, e cila erdhi vetëm pak ditë pas shpalljes së pavarësisë në Vlorë, nga plaku i historisë dhe i pavdekësisë, Ismail Qemali.

Në këtë përvjetor, ne ndjejmë një krenari të ligjshme, jo vetëm se Forcat e Armatosura janë pjesë e organizatës më të fuqishme të sigurisë në botë, sikurse është NATO, por edhe për faktin se, kemi trashëguar në vetvete vetitë më të mira në vite të kësaj ushtrie, që në moshë tashmë e ka kaluar shekullin.Sot ne kemi arritur të kemi një ushtri profesioniste, që po forcohet nga viti në vit, duke pasur vizion e synime të qarta për të ardhmen. Anëtarësimi në NATO, e tregoi Forcën e Armatosur, si një pjesë vitale të vendit tonë.

Në këtë ditë të veçantë për ne, dua të përshëndes të gjithë personelin e Forcave të Armatosura, për kontributin, angazhimin, përkushtimin, sakrificën e treguar për realizimin e të gjitha detyrave në përmbushje të misionit kushtetues. Ushtria jonë shpalos në këtë 104 - vjetor virtytet më të mira të popullit shqiptar si, besnikërinë, guximin dhe dashurinë për atdheun.

Gjej rastin të shpreh mirënjohje dhe respekt të veçantë për të gjithë ata burra e gra që kanë shërbyer ndër vite në Forcat tona të Armatosura.

Një urim të veçantë në këtë ditë, dua të përcjell për të gjithë personelin e FA që kryen detyra në shtabet dhe misionet e NATO kudo në botë. Vërtet me qindra e mijëra kilometra na ndajnë me njëri-tjetrin, por çdo çast e çdo orë ne jetojmë me ju dhe jemi krenarë se, aty në Afganistanin e largët e të trazuar, në detin Egje, Bosnjë, Kosovë, Gjeorgji, Mali etj, ju po i shërbeni stabilitetit, demokracisë dhe paqes. Ju po përfaqësoni me dinjitet kauzën e vendit tonë për një demokraci dhe qytetërim modern.

Edhe njëherë ju përshëndes të gjithëve dhe jam i bindur se falë punës dhe përpjekjeve tuaja në të ardhmen do të kemi një FA më të fortë, më të integruar në NATO dhe botën e qytetëruar.

Mirënjohje dhe respekt për punën dhe kontributin tuaj!

Urimet më të mira dhe gëzuar ditën e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë!

Miqësisht,

gjeneral brigade Dedë Prenga,

zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

> *"Në këtë ditë të veçantë për ne, dua të përshëndes të gjithë personelin e Forcave të Armatosura, për kontributin, angazhimin, përkushtimin, sakrificën e treguar për realizimin e të gjitha detyrave në përmbushje të misionit kushtetues. Ushtria jonë shpalos në këtë 104 - vjetor virtytet më të mira të popullit shqiptar si, besnikërinë, guximin dhe dashurinë për atdheun".*

Ditë e Hapur me rastin e 104 - vjetorit të FA

Me rastin e 104 - vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes organizoi, ditën e dielë, në 4 dhjetor 2016, në Garnizonin "Skënderbej", Ditën e Hapur në FA. Që në orët e para të mëngjesit, një numër i madh vizitorësh morën pjesë në këtë aktivitet, ku panë nga afër mjetet, pajisjet dhe armatimin që kanë në përdorim Forcat e Armatosura të Shqipërisë, duke filluar që nga helikopterët, mjetet e blinduara dhe armët e reja të standardeve të NATO. Vizitorët patën mundësinë të njiheshin nga afër me punën e burrave, grave dhe djemve e vajzave nën uniformë, që shërbejnë në FA. Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm, të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Dedë Prenga, pasi uroi të gjithë ushtarakët me rastin e 104 - vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura, vlerësoi punën dhe misionin e tyre gjatë këtij viti. "Me bindje mund të themi se në sajë të udhëheqjes politiko - ushtarake, por edhe të vet Shtabit të Përgjithshëm, komandat kryesore dhe ato mbështetëse kanë dhënë kontributin e tyre për realizimin e të gjitha detyrave të planifikuara për këtë vit si edhe atyre të paplanifikuara. Natyrisht që një nga detyrat dhe misionet kryesore të Forcës së Armatosur lidhet me emergjencat civile për t'iu gjendur popullatës në nevojë në çdo moment dhe për të ofruar sa më të shpejtë ndihmën. Përfitoj nga rasti të përshëndes jo vetëm ushtarakët në uniformë dhe civilët e Forcave të Armatosura, por të gjithë popullsinë edhe udhëheqjen në drejtimin e komandimit që në çdo kohë e në çdo moment ka mbështetur Forcën e Armatosur për realizimin e misionit të saj kushtetues dhe të detyrave që burojnë nga ky mision." - u shpreh gjeneral brigade Prenga.

Gjithashtu vizitorët vizituan edhe Muzeun e Forcave të Armatosura, ku gjenden të ekspozuara rreth 3600 objekte që janë përdorur nga FA shqiptare në më shumë se një shekull.





Forcat Detare me paisje moderne

Ditën e diel më 4 dhjetor në Garnizonin "Skënderbej", me rastin e 104-vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura, u organizua ditë e hapur për median dhe popullsinë civile.Në këtë kuadër, Forca Detare ekspozoi disa prej mjeteve dhe pajisjeve detare më të fundit. Njëra prej gomoneve të anijeve më të reja në Forcën Detare, ato të klasit "Iliria", pajisjet e zhytjes detare, pajisjet e bordingut, etj u ekspozuan së bashku me mjetet dhe pajisjet më të reja Forcave të Armatosura, dhe ngjallën kureshtjen e shumë vizitorëve.

Ministri Federal i Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë, z.Hans Peter Doskozil

Vizitë në batalionin Komando e Forcat Speciale

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh Shqipëri - Austri, ministri Federal i Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë, z. Hans Peter Doskozil, vizitoi më 2 dhjetor 2016 batalionin Komando dhe batalionin e Forcave Speciale të Forcës Tokësore. Zoti Doskozil u prit nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani.

Për nder të vizitës së ministrit austriak të Mbrojtjes, nga ana e efektivave komando dhe atyre të Forcave Speciale, u kryen demonstrime të veprimeve operacionale taktike si goditje objekti, çlirim pengu, veprime në prapavijë të kundërshtarit, alpinizëm, qitje precizoni me armët e këmbësorisë dhe me pushkë snajper etj.

Në përfundim të demonstrimeve, zoti Doskozil falënderoi efektivat komando dhe ata specialë për performancën e treguar. "…forcat speciale dhe ato komando janë aset i rëndësishëm dhe tepër cmuar i cdo shteti, për përdorim në raste dhe situata të vështira. Prandaj dhe në kohë paqe këto duhet të ruhen dhe të trajnohen çdo ditë…." - tha ndër të tjera ministri Federal i Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë.

22 nëntor 1908, përfundon punimet Kongresi i Manastirit, vendimi me i rëndësishëm i të cilit ishte miratimi i alfabetit të njësuar të gjuhës shqipe, prandaj shpesh quhet edhe Kongresi i Alfabetit. Por ky kongres, kishte në plan edhe çështje të tjera të arsimit. Historianët përmendin një takim të fshehtë mes delegatëve, që u zhvillua në një nga dhomat e ndërtesës ku mbahej kongresi. Është fjala për një propozim që Shahin Kolonja kishte përgatitur për t'a paraqitur në parlamentin osman. Sipas këtij propozimi, mësimet në të gjitha shkollat duhej të zhvilloheshin në gjuhën shqipe, ndërsa turqishtja si gjuhë e perandorisë duhej të hynte në këto shkolla vetëm pas klasës së katërt fillore.

Shkollat, si edhe më parë, duhej të financoheshin nga shteti, ku në prag të Kongresit të Manastirit, në trojet shqiptare funksiononin vetëm 15 shkolla. Në propozim, hidhej edhe idea e krijimit të shkollave të larta. Në buxhetin e perandorisë duhej të caktohej një fond vjetor për arsimimin e studentëve shqiptarë në Evropë ose Amerikë, ku ata të përgatiteshin për të dhenë mësime në universitetet shqiptare. Për të shmangur ndërhyrjen e Italisë, Greqisë e Austrisë në këto çështje, në mbledhjen e fshehtë në Manastir u propozua që priftërinjtë katolikë e ortodoksë të pagueshin nga shteti osman. Ky ishte një projekt i guximshëm, ndikuar edhe nga entusiazmi që rilindasit provonin në prag të Kongresit Manastirit.

Propozimi, pasqyronte vizionin e atdhetarëve të asaj kohe për arsimin, kurrë nuk u paraqit për diskutim në parlamentin osman. Ai mbeti brenda dyerve të mbyllura, ndoshta në pritje të kushteve kombëtare kur ideve për pavarësi të ishte e mirëpritur, ashtu si u deshën disa vite derisa alfabeti i miratuar në Manastir të pranohej pa kundërshtime nga të gjithë në mbarë trojet shqiptare. Në gjithë këtë zhvillim, një veçori vihet re, se në një kohë kur shqiptarët të përçarë e pa një shtet të vetin, arritën brenda pak ditësh të binin dakord për një vendim monumental, siç është alfabeti shqip.

SHIPK- fytyra e re e IS në Afganistan?!

MAJOR ERVIN HODO

(vijon nga numri i kaluar)

Për shkak të diferencave ideologjike dhe politike, talebanët afganë kishin fituar gjithashtu edhe armiqësinë e një tjetër segmenti të militantëve pakistanezë. Pakistanezët, zakonisht do të kritikonin marrëdhëniet miqësore të afganëve me qeverinë pakistanezë, ashtu sikurse edhe dështimin për të luftuar mbështetësit e qeverisë afgane. Në atë kohë, këto dallime u bënë tepër të dhunshme. Kundërshtarët e talebanëve afganë, nuk gjendeshin vetëm në Nangarhar. Sa'id Khan, komandanti i talebanëve pakistanezë (TTP) për tribunë Orakzai, i cili më vonë do të drejtonte SHIPK, përshkruhej nga burimet e talebanëve afganë si të ishte në garë me Lëvizjen, bazuar në atë çfarë ai konsideronte të ishte sipas tij një sjellje e dobët dhe e mëshirshme e talebanëve afganë, në drejtim të qeverrisë afgane. Sipas këtyre burimeve, Sa'id Khan është një salafist (i trajnuar në një medrese lokale, e themeluar në vitin 1940 me mbështetjen saudite.). Ai, përshkruhet si një njeri që ka pasur një të kaluar të karakterizuar nga sektarizmi i ashpër, si i përfshirë në sulmin ndaj mësuesit të fesë Hanafi në Orakzai, kur ishte drejtues i talebanëve pakistanezë për atë tribu.

Kur IS, shpalli kalifatin e tij në Siri dhe Irak në Korrik 2014, e ndjekur nga një lëvizje e dyshimtë nga ana e militantëve pakistanezë në Nangarhar, talebanët afganë, filluan t'i shikonin ata me shqetësim. Lëvizja ishte e ndërgjegjshme, se bashkimi i militantëve të pakënaqur në një aleancë me Shtetin Islamik të sapo shpallur, mund të përbënte rrezik për dominimin e tyre tek rebelët.



Përplasjet e para

Tensionet midis "miqve" militantë dhe talebanëve afganë, filluan në vitin 2014. Talebanët, iu kërkuan mysafirëve të largohen nga zona dhe të mbyllnin medresetë, ku trajnoheshin fëmijët e muhaxhirëve. Ata gjithashtu konfiskuan një dërgesë armatimesh në Mamand, e cila konsistonte në gjashtë mushka dhe që kushtonte rreth 5 milion rupi (monedha) pakistaneze (rreth 50000 $). Një seri negociatash midis të dyja palëve filluan nga Marsi deri në Maj 2015. Muhaxhirët refuzuan të largoheshin dhe kur luftimet shpërthyen në fillimet e 2015, të dyja palët u futën në armiqësi të hapur. Në të njëjtën kohë, militantët pakistanezë të vendosur në Nagrahar, shpallën aleancën e tyre me Shtetin Islamik. Përplasjet e para filluan në distriktin Nazian, të iniciuara nga një pritë nga luftëtarët e SHIPK, kundër talebanëve afganëve, duke vrarë dy nga shefat e tyre të distriktit. Incidenti u pasua nga sulmi i talebanëve mbi SHIPK, në Kot dhe me vonë në luginën e Mamandit. Nga mesi i Majit 2015, talebanët afganë duke qenë një minoritet në të treja distriktet, u detyruan të tërhiqen menjëherë. Forcat e Shteti Islamik i Provincës së Korosanit (SHIPK), i ndoqën talebanët nga pas në rajonet e Bati Kot, Chaparhar, Deh Bala, Khogyani, Sherzad, Pachir wa Agam, Rodat dhe Ghanikhel, duke i kapur, ose duke iu marrë shumicën e territoreve të pesë rajoneve të para të përmendura më lart. Në fund të Qershorit, SHIPK ishte në një pozicion komod në tetë distrikte dhe kjo përfaqësonte kulmin e kontrollit territorial të grupit.

Përpara se miqtë militantë të ktheheshin kundër talebanëve, këta të të fundit më përpara kishin mbajtur një qendrim të balancuar dhe kishin një këndvështrim optimist në lidhje me Shtetin Islamik, madje shumë talebanë e shikonin atë si mbrojtës të sunive në Irak dhe Siri. Pas avancimit të Majit të luftëtarëve të SHIPK në territoret e talebanëve, lidershipi i Lëvizjes hapi kanale komunikimi si me lidershipin e IS, në Siri po ashtu edhe me drejtuesit e SHIPK në brezin e tribuve afgano-pakistaneze. Një numër mesazhesh u shkëmbyen në atë kohë midis lidershipit taleban dhe qendrës së IS në Raka, nëpërmjet kanaleve personale. Në nivel lokal negociatat që kishin filluar tashmë herët në 2015, ndërmjet guvernatorit taleban për Nangarharin, Mir Gul Ahmad Hashemi, dhe guvernatorit të SHIPK, Sa'id Khan, rifilluan. Talebanët u përpoqën të bindin IS, që të largohej dhe t'ua linte atyre drejtimin e xhihadit në këtë vend. Nga ana tjetër, Sa'id Khan, kërkoi që Lëvizja talebane të shpërbëhej dhe t'i deklaronte aleancë Kalifatit. Negociatat dështuan.

Me 11 Qershor 2015 vritet në Peshawar nga ana e SHIPK, Hashemi. Katër ditë më vonë, lideri i komanduar në atë kohë i talebanëve Akhtar Muhammad Mansur, i dërgoi një letër të gjatë dhe emocionuese Kalifit të ISIS, Abu Bakr Baghdadi, duke i kërkuar atij, ose të heqë dorë nga luftimet nën flamurin e IS në Afganistan, ose t'iu bashkohet forcave talebane afgane. Përgjigja e ISIS, erdhi vetëm një javë më vonë kur zëdhënësi i tij Abu Muhammad al-Adnani duke iu referuar talebanëve si aleatë të shërbimit inteligjent pakistanez, i kërkoi Lëvizjes të pendohet ose në të kundërt do të përballej me furtunën e muxhahedinëve të ISIS. Si rrjedhojë e kësaj, grupimi i talebanëve afganë në Pakistan, lëshoi një deklaratë në të cilën iu kërkohej luftëtarëve të Lëvizjes, të vetëmbroheshin kundër ISIS.

Kundërsulmi i Talebanëve

Luftëtarët lokalë talebanë, ishin bashkuar nga disa forca elitë të Lëvizjes së re, nën komandën brutale të komandantëve nga Loy Paktia dhe Loy Kandahar. Brenda dy javëve, SHIPK kishte humbur shumicën e territorit të tij ndaj talebanëve, në distriktet jugperëndimore si në Pachir wa Agam, Khogyani dhe Deh Bala, ashtu sikurse edhe në Chaparhar, në rrethinat e Xhalabadit. Talebanët, gjithashtu shtinë në dorë një sasi të konsiderueshme armatimi në Deh Bala. Gjithësesi fushata e Lëvizjes në distriktet jugperëndimore të tilla si Achin, Kot, Bati Kot dhe Nazian, rezultoi më pak e suksesshme. E ndërsa ata ia arritën të sigurojnë mbështetjen popullore në Achin dhe u raportuan t'ia kishin arritur edhe në Kot, edhe pse u përpoqën t'i pastrojnë këto distrikte nga SHIPK, në terren u arritën vetëm disa fitore të vogla. Kjo provoi të ishte shkatërruese për popullsinë që kishte mbështetur talebanët, ose që dyshoheshin nga SHIPK se kishin vepruar si mbështetës të paktën në Achin dhe Kot. Mamandisët (banorët e Mamandit), kujtojnë se si bashkëpunimi i tyre me talebanët kundër SHIPK, përfundoi gjendjen e qetësisë 45 ditore nën qeverrisjen e Kalifatit.

Në fillimet e Korrikut 2015, luftëtarët talebanë u futën në Mamand dhe gjatë natës së 2 Korrikut folën me simpatizantët e tyre për organizimin e një sulmi, kundër luftëtarëve të SHIPK. Ata, ia arritën të sigurojnë ndihmën e disa prej drejtuesëve të fiseve. Një mëngjes gjatë Ramazanit me datë 3 Korrik 2015, burrat e zonës (duke përfshirë edhe ata që zakonisht nuk kishin simpati për talebanët) dhe talebanët u ngritën sëbashku kundër SHIPK, nën thirrjet e talebanëve me anë të altoparlantëve të xhamive, thirrje kjo për të gjithë meshkujt në moshë për të luftuar të dilnin jashtë dhe të merrnin pjesë, ose në rast të kundërt ata kishin për t'i parë shtëpitë e tyre në flakë.Të kapur në befasi, luftëtarët e SHIPK, u tërhoqën nga pjesa më e madhe e territorit të luginës së Mamandit, në fund të asaj dite.

Megjithatë, në më pak se një javë pasi u dëbuan nga Mamandi, ata kundërsulmuan duke e kapur në befasi popullsinë lokale dhe duke i detyruar talebanët të maskoheshin midis popullatës. Luftëtarët e SHIPK, duke thyer agjërimin e Ramazanit në mes të ditës, treguan mizori të paparë, sipas banorëve të zonës. Sipas rezidentëve, SHIPK iu dha talebanëve 10 minuta kohë për t'u larguar nga shtëpitë e tyre, pa marrë asnjë gjë me vete. Ata më pas vranë rreth 20 talebanë dhe burgosën rreth 80 meshkuj të zonës, të rinj dhe të moshuar. Më pas, njëmbëdhjetë nga të burgosurit u ekzekutuan në një fushë të shtruar me eksploziv, të vendosur gjithashtu në trupat e të burgosurve. Skenat e vrasjeve brutale u hodhën më pas në CD, me filmime propogandistike me 10 Gusht (vrasja në fakt ndodhi në prag të festës së Bajramit, me 16 Korrik) dhe u shpërndanë gjerësisht në mediat afgane dhe ato ndërkombëtare dhe që atëherë është bërë marka e imazhit të SHIPK.

Sipas rezidentëve lokalë, me rikthimin e SHIPK, shumica e fshatarëve nga pjesa e sipërme e luginës i braktisën shtëpitë e tyre, kafshët dhe fermat dhe u rivendosën në Xhalalbad ose në zona të tjera të sigurta. Militantët konfiskuan pronat e lëna bosh si ghanimat (shpërblim) dhe luftëtarët e rinj që vinin nga fiset e Orakzai dhe Bajaur, u vendosën në këto shtëpi, sëbashku me familjet e tyre. Për popullsinë pro-qeverritare, apo për Forcat e Sigurisë, u bë e pamundur për t'u rikthyer në zonë.

Në muajt pasardhës, përplasjet midis talebanëve dhe SHIPK, bënë që këto dy grupe të harxhojnë shumë energji kundër njëri-tjetrit, energji kjo që në kushte të tjera mund të ishte përdorur kundër qeverrisë Afgane. Në territorin e luftës intensive, distrikte të tilla si Pachir wa Agam, Chaparhar, Bati Kot dhe Deh Bala, i ndryshuan padronët e tyre tre deri në katër herë. Në territoret e kapura, secila nga palët përdori taktika të ndryshme të brutalitetit dhe spastrimit, kundër kundërshtarëve të tyre. Kjo përfshiu djegiet e shtëpive, të njerëzve të cilët dyshoheshin si të lidhur me grupet rivale, ekzekutimet publike të luftëtarëve të lidhur me armikun dhe duke i detyruar simpatizantët e rivalëve të arratiseshin dhe të braktisnin shtëpitë e tyre.

Megjithatë, pushtimi i zonave nuk rezultoi gjithmonë me kontroll të menjëhershëm të tyre. Në një rast në Chaparhar, luftëtarët e SHIPK, pasi u maskuan mes popullit dhe pasi i fshehën armët e tyre, qëndruan nën kontrollin e talebanëve për muaj të tërë. Ata u ngritën në mënyrë të befë dhe i përzunë talebanët nga shumica e rajonit në Dhjetor 2015.

Luftimet në Chaparhar, iu rikujtuan talebanëve aftësitë dhe efektivitetin e militantëve të SHIPK dhe i detyruan ata që t'i marrin më seriozisht rivalët e tyre. Me 4 Janar 2016, pasi mori një fatwa (shpallje) nga grupi pro talebanëve afganë, në favor të një ofensive "xhihadi" kundër SHIPK, talebanët filluan një operacion në shkallë të gjerë, i cili përfshiu një seri të forcave elitë të ardhura nga dhjetë provincat, plus atë të Nangarharit, në total rreth 3000 luftëtarë. Brenda tre ditëve, ata e shkulën SHIPK nga Chaparhari dhe Bati Kot, duke e kufizuar kontrollin e grupit mbi Achin, Deh Bala, Kot dhe distriktin e vogël të Nazianit.

Forcat a Sigurisë së Afganistanit, fillojnë luftën kundër SHIPK

Ndwrkohw qw luftimet në terren vunw pwrballw SHIPK kundër talebanëve, të cilët tradicionalisht kishin deklaruar kontrollin mbi vendin (qeverria kishte kohë që kishte pushuar së mbajturi kontrollin mbi distriktet e qendrës dhe të jugut të Nargarharit), të tjera luftime filluan gjithashtu midis SHIPK dhe FSKA. Megjithatë, dy muajt përfunduan pasi SHIPK kishte vendosur dominancën e tij mbi një pjesë të gjerë të territorit dhe nisi një armëpushim. Një përjashim nga ky armëpushim virtual, ishte një sulm mbi policinë në një pikëkontrolli në Kot në Qershor 2015, i cili u reportua si i pa iniciuar nga SHIPK. Grupi humbi dy nga luftëtarët e tij në këtë përplasje, një nga të cilët u raportua si i ekzekutuar nga policët, pasi ishte plagosur. Me vonë, kur të dyja palët filluan të angazhohen në luftime kundër njëri-tjetrit, SHIPK arriti të merrte në 12 raste pikat e kontrollit të FSKA, të policisë lokale afgane, por edhe të ashtu-quajturës milicia kryengritëse, duke vrarë të paktën 80 veta pjesëtarë të forcave pro-qeverritare, përfshirë këtu edhe një shef policie distrikti për Deh Balan, në Qershor 2016.

Megjithatë, në të gjitha këto raste pushtimi i pozicioneve të FSKA nga ana e SHIPK, ishte i përkoshëm dhe i shkurtër, duke shërbyer vetëm si rritës i moralit të militantëve.

Së fundmi, forcat e qeverrisë afgane duket janë angazhuar në luftime të ashpra kundër SHIPK, përsëri të mbështetur nga forcat amerikane në distriktin e Kot dhe në pjesë të Achin. Kjo u pasua nga udhëri i Presidentit Gani, për një operacion të thëllë kundër grupit për të eleminuar rrezikun. Njëkohësisht, Nangarhari u vizitua edhe nga Ministri i Mbrojtjes, nga mesi i Qershorit. Operacionet e FSKA, për herë të parë ndryshuan fokusin e SHIPK nga talebanët, në drejtim të qeverrisë afgane.

FSKA u angazhuan në disa operacione offensive kundër SHIPK në Achin, Kot, Nazian dhe Bati Kot përpara operacioneve aktuale. Në dy distriktet e para operacionet e mëparshme u zhvilluan disa herë me qëllim rimarrjen e territoreve nga SHIPK. Megjithatë në rastet e tjera ofensiva nuk arriti dot fitoren përfundimtare, madje disa herë territoret e rikapura u humbën shpejt duke kaluar sërisht në duart e SHIPK. Qeveria në mënyrë progresive është varur në të ashtu-quajturën forcë popullore, p.sh milicia e dalë nga banorwt e fuqishwm tw zonws dhe e drejtuar nga shërbimi sekret afgan. Këto forca, kanë provuar të jenë efektive të paktën në ndalimin e SHIPK, për të avancuar më tej. Së fundmi kjo milici lokale janë bërë objekti kryesor i operacioneve më të mëdha të SHIPK. Në Qershor 2016, SHIPK dhe aleati i tij Lashkar-e Islam, kryen tre sulme kamikaze kundër komandantëve të kësaj milicie, çka i korrespondon një të tretës së të gjitha sulmeve kamikaze që Shteti Islamik i Provincës së Korosanit (SHIPK), ka kryer deri tani.

Asnjë ndërhyrje nga Forcat e Sigurisë Kombëtare Afgane(FSKA) gjatë muajve të formimit të SHIPK

Militantët pakistanezë, nuk e filluan menjëherë pasi ndërruan flamurin e tyre, luftën kundër qeverisë afgane. Por, nga ana tjetër as FSKA, nuk u përfshi në ndonjë plan operacioni kundër SHIPK, pas shfaqjes së tij publike. FSKA dhe punonjësit e qeverisë duket se u toleruan fillimisht nga SHIPK, deri në fillim të Qershorit 2015; luftimet në Kot në fillim të Qershorit gjatë së cilëve u vranë dy anëtarë të SHIPK, njëri prej të cilëve pasi kishte qenë i dënuar më parë, u raportua menjëherë nga ana e policies, por megjithatë dukej se nuk pati ndonjë reagim të madh nga ana e FSKA. Padyshim që nga fundi i Qershorit 2015, pushteti vendor dhe zyrtarët e FSKA e pranuan se ata nuk ishin duke goditur luftëtarët e SHIPK. Në atë kohë, dukej se zyrtarët e shikonin SHIPK si një mjet të fuqishëm për të goditur dhe shkatërruar armikun tradicional të qeverisë, Talebanët.

Rezidentët e zones, si dhe anëtarë të FSKA, kujtojnë se gjatë gjithë muajit Maj dhe Qershor 2015, në disa zona si Mamand, SHIPK shkoi aq larg sa të përgëzonte dhe të fliste mirë për FSKA. Ideja e parë se SHIPK ishte bërë gati për të ndërruar sjelljen e tij të paktën ndaj FSKA dhe jo plotësisht ndaj qeverrisë, ishte në një film propagande i hedhur në qarkullim me 12 Korrik 2015.

(vijon në numrin e ardhshëm)



Temë kryesore e kësaj konference ishte “Përmirësimi i nderoperacionalitetit dhe qasja e përbashkët drejt qëllimeve të partneritetit/objektivave dhe aftësimi përmes trajnimeve dhe ushtrimeve të kombinuara”. Qëllimi i kësaj konference ishte edhe shkëmbimi i përvojave në mes shteteve të cilat kanë kaluar nëpër fazat kryesore për anëtarësim në NATO dhe të atyre të cilat synojnë anëtarësimin e plotë në NATO.



Konferenca 20-të “SHBA-Karta e Adriatikut A-5”

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Shefit të Shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjeneralit Mirko Shundov, mori pjesë në Konferencën e 20-të “SHBA-Karta e Adriatikut A-5” të shefave të Mbrojtjes.

Në Konferencën Karta Adriatikut–A5, e cila këtë vit, u mbajt në Split të Kroacisë nga data 29.11 e deri më 1.12. 2016, ku moren pjesë shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kroacisë, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë, si dhe vendet vëzhguese si: Sllovenia dhe Kosova. Po ashtu në Konferencë pjesëmarrës ishin edhe zëvendës komandant i forcave amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Thimothy M. Raya, komandantët e Gardës Kombëtare të vendeve partnere nga Shtetet e Bashkuara.

Temë kryesore e kësaj konference ishte “Përmirësimi i nderoperacionalitetit dhe qasja e përbashkët drejt qëllimeve të partneritetit/objektivave dhe aftësimi përmes trajnimeve dhe ushtrimeve të kombinuara”. Qëllimi i kësaj konference ishte edhe shkëmbimi i përvojave në mes shteteve të cilat kanë kaluar nëpër fazat kryesore për anëtarësim në NATO dhe të atyre të cilat synojnë anëtarësimin e plotë në NATO.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë kësaj konference ka zhvilluar takime dypalëshe me shefat e mbrojtjes të shteteve pjesëmarrëse, si të SHBA-së, Kroacisë, Maqedonisë dhe Malit të ZI.Pjesë e delegacionit kosovar ishte edhe këshilltari i komandantit, major Berat Shala dhe rreshteri i parë i FSK-së, Genc Metaj.

Britania trajnon oficerët e FSK-së

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli priti më 1 dhjetor 2016, në një takim pune zëvendës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, z. Tom Adams.Ministri Demolli e falënderoi z. Adams, për ndihmën e vazhdueshme që Britania e Madhe po jep për FSK-në, si në aspektin material dhe atë profesional. Ministri Demolli gjithashtu e falënderoi zv. ambasadorin e Britanisë, për mundësitë e afruar nga Mbretëria e Bashkuar për shkollimin dhe trajnimin e oficerëve të FSK-së, në Akademinë Mbretërore Ushtarake si dhe për pjesëmarrjen e njësitit të FSK-së, në garën ndërkombëtare të marshimit, në Wels, ku FSK-ja u nderua me medaljen e art, në mesin e dhjetëra ushtrive pjesëmarrëse të botës. Më pas, ministri Demolli, theksoi bashkëpunimin e mirë që MFSK-ja ka me Ministrinë e Mbrojtjes të Britanisë si dhe për mundësinë e vazhdimit dhe



thellimit të këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen në interes të dyja vendeve. Nga ana e tij, zv. ambasadori Tom Adams e falënderoi ministrin Demolli, për mikpritjen dhe premtoi vazhdimin e bashkëpunimit si dhe ndihmës së mëtejmë të Britanisë së Madhe për Kosovën dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në takim ishin prezent edhe shefi i Kabinetit të ministrit, z. Latif Leka.



SHBA: Jeffrey H. Fisher, atadheu ushtarak në Kosovë

Sekretari i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z.Ashtan Carter, përmes një letre drejtuar ministrit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, e njofton atë zyrtarisht me emërimin e kolonelit Jeffrey H.Fisher, atashe të Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë. Më tej, në letër, sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, z.Carter, shpreh bindjen se emërimi i kolonelit Jeffrey Fisher, në detyrën e atasheut të mbrojtës, me përvojën dhe kualitet që ka do të kontribuojë në interes të dyja vendeve tona.

> Ministri Jolevski: Pikërisht për pjesëmarrësit e ARM-së në kufirin jugor kemi marrë me qira kapacitet në Bogdanci, të cilin e kemi rinovuar plotësisht. Poashtu vazhdojmë me ngritjen e standardit të pjesëtarëve të ARM-së me projektet si "ARM-Shtëpia Im e Vërtetë", pagat ditore për angazhimin në kufi paguhen rregullisht, investojmë në arsimimin dhe trajnimin e tyre me çka ata fitojnë shkathtësi dhe dituri të cilat do ti shfrytëzojnë në të ardhmen.



"Panairi i Bamirësisë i NATO-s 2016"

Misioni i Republikes së Maqedonisë pranë NATO-s me mbështetje të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme në mënyrën më të mirë prezantoi dhe afirmoi ndërkombëtarisht Republikën e Maqedonisë në „Panairin Bamirës të NATO-s 2016"" i cili u mbajt kohëve të fundit në hapësirat e Selisë së NATO-s në Bruksel.



Në këtë manifestim vendet anëtare të NATO-s dhe vendet partnere prezantohen përmes shtandeve të tyre ku shiten produkte vendore. Të ardhurat nga produktet e shitura dhurohen për projekte paraprakisht të zgjedhura, zakonisht për fëmijët pa prindër, fëmijët me nevoja të veçanta apo projekte tjera humanitare. Në këtë mënyrë sigurohen mjete financiare të konsiderueshme për qëllime bamirëse.

Shtandi i Misionit të Republikës së Maqedonisë në NATO, u ndoq nga një numër i përfaqësuesve të lartë të vendeve anëtare të NATO-s dhe partnerët, duke përfshirë edhe Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të ri të NATO-s, Rose Gottemoeller, i cili informoi se gjatë ditës së kaluar ka pasur një takim të shkëlqyer me ministrin Zoran Jolevski në forumin e sigurisë në Halifax, Kanada. Me këtë rast përshëndeti përpjekjet e investuara nga Republika e Maqedonisë në zbatimin e reformave të nevojshme.



Partneritet në vlerat e përbashkëta

Thellimi i bashkëpunimit mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe përdorimi i ndërsjellë i kapaciteteve rajonale ishin tema të bisedës gjatë vizitës dhe gjatë takimit të zëvendës ministrit të mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë Bekim Maksutit dhe zëvendës ministrit të Forcave të Sigurisë së Kosovës, Muhamet Latifit në Prishtinë.

„Republika e Maqedonisë Kosovën e njeh si partnere dhe mbështetëse e cila ndanë vlerat e përbashkëta e të ndërsjella siç janë paqa, demokracia dhe barazia", theksoi gjatë këtij takimi zëvendës ministri Maksuti. Në këtë drejtim, ne jemi të gatshëm të vazhdojmë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, e sidomos në sferën e shkollimit ushtarak, duke pasur parasysh se Akademia Ushatarake në Shkup është institucion i larët ushtarak shkollor i respektuar edhe në nivel rajonal.

Zëvendës ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Latifi tha se Maqedonia është partnere e rëndësishme e Kosovës, ndërsa njëherit shprehu kënaqsinë për nivelin e lartë të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. "Kosova dhe Maqedonia ngelin faktor i rëndësishëm i stabilitetit dhe i sigurisë në rajon. Për ne është tejet i rëndësishëm bashkëpunimi dhe qëllimi ynë është që t'a zhvillojmë dhe t'a thellojmë të njëjtin edhe në të ardhmen", shtoi Latifi. Ai nga zëvendësi Maksuti kërkoi mbështetjen e Republikës së Maqedonisë për anëtarsimin e plotë të Kosovës në nismat rajonale dhe njëherit ofroi kapacitetet e qendrës rajonale të hulumtimit dhe shpëtimit në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në kuadër të vizitës zyrtare, zëvendës ministri Maksuti zhvilloi takim edhe me ministrin e FSK-së, Haki Demollin, me sekretarin e përgjithshëm Shkëlzen Silaj dhe me komandantin e kësaj force, gjeneral-kolonelin Rahman Rama.Zëvendës ministri i mbrojtjes Bekim Maksuti mes tjerash gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës, si kryesues i delegacionit vizitoi edhe kompleksin memorial "Adem Jashari" në Prekaz të Drenicës.

Pjesëmarrje e ARM-së në kufirin jugor

Ministri i Mbrojtjes Zoran Jolevski vizitoi pozitat e Armatat e Republikës së Maqedonisë në kufirin jugor në pjesën e Gjevgjelisë, ku njëkohësisht iu bashkua edhe në aksionin e 17-të me rradhë „Dita e Drurit-Mbjell Ardhmërinë Tënde." Njëkohësisht, ministri Jolevski vizitoi edhe kapacitetet akomoduese të Armatës në Bogdanci ku edhe drekoi me pjesëtarët e ARM-së.

"Sot ndodhem në vizitë të pjesëtarëve të Armatës të cilët i japin mbështetje policisë në sigurimin e kufirit. Ne si ministri dhe Qeveri ndjekim zhvillimin e gjendjes së krizës migrante, gjithçka që ndodh në Evropë, por edhe në Greqi dhe Turqi, që të reagojmë në mënyrë adekuate në rast se shtohet rrjedha e emigrnatëve", tha ministri në karaulën në Gjevgjeli, lokacion ky që ishte kyç në përballjen me krizën e emigrantëve. Ministri theksoi se vazhdimisht mbahen takime me ministrat e mbrojtjes, si dhe me përfaqësues të Komesarijatit të Lartë për Refugjatë përmes së cilave ndiqet situata. Ne kemi zhvilluar strategji dhe opsione të ndryshme, shtoi ministri, ashtu që Maqedonia është e sigurtë.

Duke u përgjigjur një pyetje gazetari rreth planeve të ardhshme në raport me ngritjen e standardit të pjesëtarëve të ARM-së, ministri Jolevski theksoi se ky është një qëllim i vazhdueshëm i Ministrisë. "Pikërisht për pjesëmarrësit e ARM-së në kufirin jugor kemi marrë me qira kapacitet në Bogdanci, të cilin e kemi rinovuar plotësisht. Poashtu vazhdojmë me ngritjen e standardit të pjesëtarëve të ARM-së me projektet si "ARM-Shtëpia Im e Vërtetë", pagat ditore për angazhimin në kufi paguhen rregullisht, investojmë në arsimimin dhe trajnimin e tyre me çka ata fitojnë shkathtësi dhe dituri të cilat do ti shfrytëzojnë në të ardhmen", shtoi ministri Jolevski.

Në kuptimin e aksionit për mbjelljen e drunjve, ministri Jolevski dhe kryetari i Komunës së Gjevgjelisë, Ivan Frangov mbollën pemë të cilat, siç tha ministri, përfaqësojnë të ardhmen e vendit. "Pyjet janë pasuri për një vend dhe një popull, ato ndikojnë në klimën dhe bujqësinë. Mirëpo, është shumë e rëndësishme që në një veprim i këtillë i bukur unë jam i



sigurt se do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ne krijojmë zakone të reja dhe një qasje të re të të rinjve ndaj pyjeve ", tha ministri.

Gjatë ditës së aksionit, në 60 lokacione në të gjithë Republikën e Maqedonisë janë mbjellë mbi 2,5 milion pemë. Në mbjelljen, si çdo vit, në mënyrë aktive u përfshinë edhe pjesëtarë të Armatës së Republikës së Maqedonisë. Në aksionet e mëparshme janë mbjellë rreth 13.000 hektarë me mbi 35 milionë fidanë.

Në kohën e kryesisë bullgare theksi i bashkëpunimit do të bjerë mbi Qendrën e Informacionit dhe Komunikimeve në Burgas, e cila kohët e fundit të fitoi një autoritet ndërkombëtar. Bashkëpunimi i specializuar do të zhvillohet dhe pasurohet me stërvitjet e përbashkëta , të cilat tashmë janë tradicionale “Fajkua e Detit të Zi”.



Nuk ka sprapsje nga pozita e përbashkët

Pas ditës së parë të takimit të ministrave të punëve të jashtme nga NATO-ja në Bruksel Ministri bullgar i Punëve të Jashtme në dorëheqje Daniell Mitov deklaroi se Bullgaria vazhdon të ngulë këmbë që Rusia të zbatojë marrëveshjet e Minskut. Nuk ka sprapsje nga pozita e përbashkët e NATO-s, që përkrahet nga pala bullgare, se Krimea është aneksuar paligjshëm dhe i përket Rusisë. Derisa të mos zbatohen këto marrëveshje, sanksionet vazhdojnë të jenë valide, nënvizoi Ministri i Jashtëm i Bullgarisë.



Nderkohë ministri i Punëve të Jashtme Daniell Mitov bëri të ditur se Bullgaria i ka bërë thirrje Komisionit Evropian për të filluar punë sipas planit “B”, në qoftë se Turqia zbaton qëllimet e saj t’i hapë kufijtë për migrantë drejt Evropës. “Shpresojmë se nuk do të arrihet deri në këtë situatë, por nuk mund ta mbështesim politikën tonë vetëm te shpresat. Në nivel kombëtar Bullgaria disponon të gjitha masat e mundshme për kufizimin e rrymave të migracionit”, shtoi Mitov. Ministri, i cili mori pjesë në takimin e ministrave të jashtëm nga NATO-ja, bëri të ditur se Aleanca do të ndjekë situatën lidhur me migracionin në Detin e Zi dhe deri tani nuk ka të dhëna se atje ka tension. Mirëpo, po të duken simptoma për një tension të tillë, NATO-ja dhe BE-ja duhet të jenë gati të reagojnë.



Jep dorëheqjen Gjeneral Kostandin Popov

Shefi i mbrojtjes gjeneral Konstantin Popov ka parashtruar një raport për lirim nga detyrat e tij. Gjenerali Popov e ka cilësuar dorëheqjen e tij si një veprim moral, sepse në vazhdim të disa viteve ka qenë udhëheqës i drejtpërdrejtë i presidentit të sapo zgjedhur Rumen Radev. Me dorëheqjen e tij gjenerali i ofron mundësi presidentit të ri që vetë të përcaktojë ushtarin më të lartë, me të cilin do të punojë për zhvillimin e Ushtrisë Bullagre.

Forumi i Dikastereve Kufitare në rajonin e Detit të Zi

Në qytetin bullgar bregdetar Burgas këtë javë u takuan udhëheqësit e dikastereve kufitare/rojeve bregdetare të Bullgarisë, Rumanisë, Rusisë, Turqisë, Ukrainës dhe Gjeorgjisë. Forumi është një model i suksesshëm rajonal për ndarjen e përgjegjësisë dhe për veprime të përbashkëta kundër kriminalitetit të organizuar dhe terrorizmit ndërkufitare në Detin e Zi. Në këtë mbledhje në Burgas Bullgaria mori kryesinë në parim rotacioni nga Rusia dhe do të jetë në krye të forumit një vit. Shteti ynë tashmë ka përvojë në këto detyrime, sepse do t’i plotësojë ato për herë të katërt. Përgjegjësitë e reja të Bullgarisë vijnë në një situatë të ndërlikuar, të lidhur me riorientimin e fluksit të migrantëve, të cilët për shkak të kufizimit të mundësive për lëvizje në rrugë tokësore, fillojnë t’i parapëlqejnë itineraret detare.



Më parë duhet të nënvizojmë se aktualisht nuk ka një fluks të përforcuar për në Bullgarinë, ujërat bullgare monitorohen vazhdimisht dhe vitin e kaluar nuk janë regjistruar raste të migracionit atje. Por përveç se kjo është në përparësi, është edhe një sfidë për rojet tona bregdetare – të parandalojnë raste të tilla në të ardhmen.

Në kohën e kryesisë bullgare theksi i bashkëpunimit do të bjerë mbi Qendrën e Informacionit dhe Komunikimeve në Burgas, e cila kohët e fundit të fitoi një autoritet ndërkombëtar. Bashkëpunimi i specializuar do të zhvillohet dhe pasurohet me stërvitjet e përbashkëta , të cilat tashmë janë tradicionale “Fajkua e Detit të Zi”. Mirëpo kryesia bullgare përkon edhe me fillimin e veprimtarisë së Rojës Kufitare Bregdetare Evropiane, e cila u themelua para pak kohe me qëllim që të mbrojë kufijtë e jashtëm të BE-së.

Ndoshta muajt e ardhshëm do të bëhemi dëshmitarë të bashkëpunimit të Forumit me këtë strukturë – që do të jetë me dobi për të dy strukturat. Si anëtare e këtyre dy organizatave, Bullgaria do të ngarkohet me përgjegjësi suplementare.

Stërvitja “Cyber Koalicioni-2016”

Një ekip i koordinuar nga Ministria e Mbrojtjes, mori pjesë në stervitjen më të madh të NATO-s, “Cyber Koalicioni-2016”. Stervitja më e madhe e NATO-s, “Cyber Koalicioni-2016” u mbajt nga 28 nëntor deri më 2 dhjetor 2016. Në këtë stërvitje moren pjesë më shumë se 700 ekspertë nga pothuajse të gjitha vendet anëtare të NATO-s dhe vendeve partnere. Republika e Bullgarisë u përfaqësua nga një ekip i përbashkët, koordinuar nga Ministria e Mbrojtjes, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga qeveria dhe institucionet shkencore dhe sektorit privat.

Një element i rëndësishëm i ushtrimit ishte një sulm simuluar kibernetik në të cilin pjesëmarrësit punuar së bashku për të identifikuar rrezikun dhe për të minimizuar pasojat e para të shpërndarjes në sistemet kombëtare. U aplikuan metoda për ndarjen e informacionit në lidhje me incidentet dhe procedurat për veprim të përbashkët mbrojtëse në rast të një sulmi kibernetik.

Sipas qëllimit të mbrojtjes kibernetike të NATO-s është tashmë i pranishëm në shumë prej mësimeve të ushtrimeve të kryera dhe të veçanta, përqëndruar në, “Cyber Koalicioni”. Nëpërmjet këtyre ushtrimeve personeli i angazhuar në mbrojtjen kibernetike, është duke u përgatitur për t’iu përgjigjur në mënyrë adekuate sfidave në nëpërmjet skenarëve reale në një mjedis virtual.



Chapecoense, miliona për ringritjen nga drama

Konfederata e Futbollit të Amerikës Latine vendosi të mos presë këshillin drejtues të 21 dhjetorit për të zyrtarizuar titullin e Kupës Amerikano jugore në favor të Chapecoense. Skuadra që thuajse u shfaros nga aksidenti ajror, ndërsa po shkonte në Kolumbi për finalen ndaj Atletico Nacional përvetëson kështu trofeun në mënyrën më të hidhur, në atë mënyrë që nuk do të kishte zgjedhur kurrë ta merrte.

Brazilianët fitojnë dhe aksesin në Rekopa, trofeu i Superkupës që do të zhvillohet pikërisht me Atleticon, skuadra e cila hoqi dorë nga titulli si homazh për ekipin e prekur nga tragjedia. Për ekipin karioka të impenjuar tashmë në fazën e vështirë të rindërtimit, vjen një ndihmë e madhe përmes 3.5 milionë eurove nga trofeu. Atletico Nacional, ndërkohë, ka marrë medaljen e argjendit dhe gjithçka përfshin nga ana financiare, por jo vetëm kaq. Do të fitojë edhe çmimin e Fair Play-t që konsiston në një çek të majmë 1 milion euro. Chapecoense ka fituar solidaritetin e mbarë botës në rrugën e vështirë të mbijetesës, madje yje të tillë si Ronaldinho, apo Gudjohnsen janë ofruar të luajnë falas për brazilianët.



"France Football": Neymar, futbollisti më i shtrejtë

Neymar është futbollisti më të kushtueshëm në merkato. Ky është përfundimi i një studimi të Observatorit të Futbollit, i publikuar nga revista prestigjioze "France Football". Sipas këtij studimi, braziliani Neymar kryeson këtë listë me një vlerë në merkato prej 250 milionë eurosh.

Në vendin e dytë qëndron Lionel Messi me 190 milionë euro, ndërsa vendi i tretë mbahet nga Griezmann me 135 milionë euro, 5 milionë më shumë se Ronaldo ne vendin e katërt. Në 7 vendet e para të klasifikimit, janë 6 futbollistë që luajnë në Ligën Spanjolle, me Pogba që ndodhet mes tyre. Por duke parë klasifikimin e 50 vendeve të para, ajo që dominon është Premier League.

Kampionati anglez ka në përbërje në këtë klasifikim 18 futbollistë kundrejt 16 të atyre që janë pjesë e La Ligës. Reali i Madridit është skuadra që ka më shumë përfaqësues në renditjen e lojtarëve më të shtrenjtë, 8. Barcelona e Bayern kanë 5 futbollistë secila, ndërsa nga Premier League Man.United, Manchester City dhe Chelsea, përfaqësohen nga 4 lojtarë secila.




"France Football" shkoi edhe më tej dhe përpiloi edhe formacionin me futbollistët më të shtrenjtë ku të bën përshtypje lënia jashtë e Cristiano Ronaldos. Skuadra e krijuar kap vlerën 1.1 miliardë euro ku përveç Neymar, Messit, Griezmann apo Pogba përfshihen edhe emra të tillë si De Gea, Marquinhos, Bonucci, apo edhe Verratti.

> *Kampionati anglez ka në përbërje në këtë klasifikim 18 futbollistë kundrejt 16 të atyre që janë pjesë e La Ligës. Reali i Madridit është skuadra që ka më shumë përfaqësues në renditjen e lojtarëve më të shtrenjtë, 8. Barcelona e Bayern kanë 5 futbollistë secila, ndërsa nga Premier League Man.United, Manchester City dhe Chelsea, përfaqësohen nga 4 lojtarë secila.*

Evazioni fiskal, nën hetim edhe Luka Modric

Luka Modric është vënë në shënjestrën e hetimeve të organeve tatimore spanjolle. Sipas asaj që publikon e përditshmja "El Mundo", mesfushori kroat ka kryer evazion fiskal duke transferuar në një kompani me seli në Luksemburg të ardhurat e përfituara nga të drejtat e imazhit të periudhës 2012-2014.

Gjithnjë sipas "El Mundo", Modric e krijoi shoqërinë "Ivano SARL" në dhjetor të vitit 2012, 4 muaj pas transferimit të tij tek Reali i Madridit. Mësohet se Modric figuron si aksioneri i vetëm i kësaj kompanie, ndërsa bashkëshortja e tij, Ivana është në rolin e menaxheres. Por jo vetëm kaq, "El Mundo" bën të ditur se në këtë kompani, shfaqet edhe një shtetas belg në rolin e administratorit.



Shoqëria "Ivano SARL" u krijua me një kapital prej 3.6 milionë eurosh dhe në 2 vjet e shtoi pasurinë e saj deri në 6 milionë euro për të bërë më pas investime në disa aspekte.

"El Mundo" bën të ditur gjithashtu se organet tatimore spanjolle kanë nisur hetimet ndaj Modric që në 18 janar të këtij viti, proces që po vazhdon ende. Mësohet se futbollisti kroat nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga marketingu, por ka konfirmuar ekzistencën e shoqërisë që zotëron në Luksemburg. Sipas "El Mundo", krijimi i kësaj shoqërie e ka lejuar Modric që të paguajë vetëm 1% të të ardhurave, ndërkohë që në Spanjë ai do të ishte i detyruar të paguante 30%, shifër kjo që do të shkonte në 51% sipas modifikimeve të bëra së fundmi në organet fiskale iberike.

Lewandowski, kontrata 15 milionë euro në sezon

Robert Lewandowski ka arritur marrëveshjen me Bayernin e Mynihut për rinovimin e kontratës dhe zyrtarizimi do të bëhet shumë shpejt.Lajmi është konfirmuar nga agjenti i Lewandowskit, Mark Barthel, i cili deklaroi se futbollisti pritet të nënshkruajë kontratën e re brenda këtij viti.Robert Lewandowski u transferua te Bajerni i Mynihut nga Borusia e Dortmundit në verën e vitit 2014 për të nënshkruar me bavarezët deri në vitin 2019. Kontrata e re e sulmuesit polak me kampionët e Gjermanisë do të skadojë në vitin 2021 dhe paga e tij do të jetë 15 milionë euro në sezon, e njëjta shifër që përfiton edhe futbollisti tjetër i Bajernit, Thomas Muller. Robert Lewandowski gjatë këtyre 3 sezoneve ka zhvilluar me Bajernin 120 ndeshje, duke shënuar 83 gola.



Niset kontigjeneti i peste për Afganistan

Ditën e hënë, më 5 dhjetor 2016, Shqipëria ka nisur kontingjentin e radhës që do të shërbejë në Resolute Support Mission (RSM), në Afganistan. Ceremonia për përcjelljen e kontingjentit u zhvillua në mjediset e Policisë Ushtarake (PU). Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Dedë Prenga, ambasadori i Republikës së Turqisë në vendin tonë z. Hidayet Bayraktar, komandanti i PU kolonel Arben Kingji, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të MM dhe SHPFA si dhe familjarë të efektivëve që do të nisen në mision.





Forcat e Armatosura të Shqipërisë prej 14 vjetësh, janë të pranishme në Afganistan. Ministrja Kodheli tha se: "Për një kohë të gjatë kam diskutuar me drejtuesit e Shtabit të Përgjithsh por dhe me komandantin e Policisë Ushtarake, për të bë të mundur përfaqësimin e ba lionit tuaj në një mision jash vendit. Dhe ja ky moment u bë realitet! Momente të tilla mbajnë mbi vete edhe shum tension, mbi të panjohurën që ju pret dhe rreziqet që çd mision i tillë ka".





Kurse ambasadori i Turqisë në vendin tonë, z. Hidayet Bayraktar, i dha një rëndësi të veçantë marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Ai u shpreh: "Turqia ka mbështetur integrimin e Shqipërisë në institucionet euroatlantike, ndërkohë ajo ka mbështetur edhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Turqia, ashtu si në çdo fushë edhe në fushën ushtarake, ka marrëdhënie të shkëlqyera me Shqipërinë."

Më pas, ministrja Kodheli i dorëzoi flamurin kombëtar, komandantit të Kontingjentit të 5-të që niset në Afganistan.Kontingjenti i PU që niset në Afganistan, shënon Kontingjentin e 5-të të efektivave shqiptarë në kuadër të RSM. Ata pritet të zëvendësojnë trupa të kontingjentit të 4-të të Batalionit Komando, të cilët janë aktualisht duke kryer misionin e tyre në varësi të komandës turke në Kabul, Afganistan. Ashtu sikurse edhe kontingjentet e tjera, toga e efektivëve të PU, do të shërbejë për një periudhë 6 - mujore.

